



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2020:163538

Datë: 04.03.2021

Numri i dokumentit: 01644147

**P.nr.986/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtarja Fitore Daci, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.H., nga fshati ....., Komuna Shtime, për shkak të veprës penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 paragrafi 1, te KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1180/20 të datës 20.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në praninë e përfaqësueses së akuzës - Prokurores së shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, përfaqësuesit të dëmtuarës Institucionit financiar ..... SH.A, Av.Besmir Rrahmani dhe të akuzuarit V.H., me datë 04.03.2021 mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari:**

**V.H.**, i lindur me date ....., në fshatin ....., Komuna Shtime, me vendbanim në rrugën ".....", nr....., i martuar, baba i tre fëmijëve, i punësuar, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, pronar i biznesit ".....," me numër të biznesit ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

#### **Sepse:**

Me qëllim të pengimit të realizimit të së drejtës pronësore, i pandehuri ka tjetërsuar sendet në te cilat ka pasur të drejtën e pengut personi tjetër, ashtu që i njëjti ka shitur automjetin e markës "....." dhe një pjesë të pajisjeve te biznesit, në atë mënyrë qe ka vepruar ne kundërshtim me

Kontratën për Kredinë dhe Marrëveshjen mbi Kolateralin-Pengun e Luajtshëm numër ....., kjo gjendje është vërtetuar me procesverbalin e përmbaruesit privat të datës 10.02.2020 edhe pse e ka ditur se këto sende nuk mund të tjetërsohen -shiten para përmbushjes së detyrimeve kontraktuese ndaj kreditorit, me çka Institucionit Financiar Jo Bankar ".....", i ka shkaktuar dëm në shumën prej 5.000€.

**me këtë veprim ka kryer veprën penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par.1 të KPRK-së.**

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 7, 8, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365, të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

**Me dënim me gjobë në shumën prej 400 € /katërqind euro/, të cilën gjobë obligohet të e paguaj në aftat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të e merr formën e prerë.**

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuajë nga një ditë burgimi.

E dëmtuara Institucionit Financiar Jo Bankar ".....", me seli në Ferizaj, rruga ".....", me përfaqësuesin e saj Av.Besmir Rrahmani, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 Euro (njëzet euro) në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

Detyrohet i akuzuari që në emer të fondit për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajë shumën prej 30€ /tridhjetë euro/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën e saj PP.II.nr.1180/20 të datës 20.11.2020, ka ngarkuar të akuzuarin V.H. nga fshati ....., Komuna Shtime, për veprën penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën shqyrtim prokurorja e shtetit lexoi aktin akuzues, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin të e shpallë fajtor dhe të i shqipton një sanksion penal sipas ligjit.

Gjyqtarja pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 dhe përkundër paralajmërimit për nenet 325 dhe 323 të KPPK-së, i ofroi mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

Në këtë shqyrtim i akuzuari V.H. ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza.

Gjykata me date 04.03.2021, cakton dhe mban seancën e shqyrtimit gjyqësorë, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin Prokurorja e shtetit Mimoza Sylaj-Hyseni, përfaqësuesi i të dëmtuarës Institucionit Financiar Jo Bankar ".....", me seli në Ferizaj, Av.Besmir Rrahmani dhe i akuzuari V.H..

Në seancën e shqyrtimit gjyqësorë i akuzuari V.H. deklaroi se: e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën me ngarkon aktakuza, më vjen keq që e kam kryer këtë vepër penale, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme penale, këtë vepër penale e kam kryer pa i menduar mirë pasojat, kërkoj nga gjykata që mundësisht të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pasi që i akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë, konform nenin 326 par.2 të KPRK-së, gjyqtarja ka kërkuar mendimin e Prokurores së shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit e cila ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarin, pasi pranimi fajësisë është në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 326 dhe 248 të KPRK-se, si dhe provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPR-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Informacioni Parakontraktor për Ekspozim të Kreditoreve i datës 29.08.2018, Kontrata për kredi të biznesit numër ..... e datës 29.08.2018, Marrëveshja mbi Kolateralin( Pengun e luajtshëm) numër ..... e datës 29.08.2018, Plani i pagesave/Amortizimit i datës 29.08.2018, Certifikata e regjistrimit të biznesit të kredi marrësit ".....", SH.P.K, Procesverbali i përpiluar nga përmbaruesi privat numër P.Nr.762/19 i datës 10.02.2020, Kontrata për shitblerjen e automjetit me numër LRP.Nr.5126/2018 dhe numër të referencës REF.Nr.1754/2018 i datës 27.08.2018, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore.

Me qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, shqyrtimi gjyqësor konform nenin 326 par.4 të KPRK-se ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare deklaron se: mbetem në tërësi pranë Aktakuzës me numër PP/II.Nr.180/20 të datës 20.11.2020, pasi që i akuzuari në këtë fazë të procedurës e ka pranuar fajësinë dhe pasi që pranimi i fajit është bërë konform nenit 248 të KPPRK-së, e njëjta mbështet në faktet që i përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin të e shpallë fajtor dhe të i shqipton dënimin e paraparë me ligj.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës, Institucionit Financiar Jo Bankar ".....", me seli në Ferizaj, Av.Besmir Rrahmani, fjalën e tij përfundimtare deklaron se: në tërësi si në fjalën përfundimtare të Prokurorës së shtetit dhe shton se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe paraqet kërkesë pasurore-juridike.

I akuzuari V.H. në fjalën e tij përfundimtare deklaron se: me vjen keq që e kam kryer këtë veprë penale, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme penale dhe këtë veprë penale e kam kryer pa i ditur fare pasojat e së njëjtës, andaj kërkoj nga gjykata të më shqiptoj dënim sa më të butë.

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuarit ne shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, i martuar, baba i tre fëmijëve dhe në rastin konkret si rrethane renduese mori faktin se i akuzuari është i dënuar me Aktgjykim të formës së prerë dhe atë me numër P. Nr.506/20 të datës 22.07.2020 për veprën penale të Dhunës ne familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, dhe po ashtu vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale).

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

#### **DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**

**P.nr. 986/20 datë 04.03.2021**

**Bashkëpunëtori profesional  
Shkelzen Polloviqi**

**Gjyqtarja  
Fitore Daci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate, kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal.